



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 997/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit M...H... Sh.p.k, me nr. të biznesit ..., seli në Gjilan, kundër debitorit A...G... Sh.p.k, me nr. të biznesit ... me seli në Prishtinë, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve J...A..." Sh.p.k me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 242/21 të datës 07.10.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit A...G... Sh.p.k me seli në Prishtinë i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor Përmbartimor P.nr. 242/21 të datës 07.10.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr. 242/21 i datës 07.10.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit përmbartimor P.nr. 242/21 të datës 07.10.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve: Faturë nr. 82/2021 të datës 30.03.2021, faturës nr. 113/2021 të datës 19.04.2021, faturës nr. 109/2021 të datës 16.04.2021, faturës nr. 103/2021 të datës 13.04.2021, faturës 100/2021 të datës 08.04.2021, faturës 96/2021 të datës 06.04.2021, faturës nr. 92/2021 të datës 03.04.2021 dhe faturës 85/2021 të datës 02.04.2021 duke urdhëruar debitorin që t'i paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 2,193.50 €, (dymijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre euro e

pesëdhjetë euro cent) si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të Urdhrit për Përbarim.

Debitori ka paraqitur Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përbarimor P.nr. 242/21 të datës 07.10.2021, me arsyetimin se debitori në vazhdimësi është duke paguar fatura të kreditorit, e cila dëshmohet edhe nga vetë teksti i propozimit për përbarim ku pohohet nga kreditori, dhe se debitori nuk ka për qëllim t'i shmanget pagesave të detyrimeve. Ka shtuar se kreditori është dashur të specifikoj se cilat fatura janë të papaguara dhe të saktësoj shumën e kërkuar për përbarim bazuar në faturat e prezantuara dhe jo të kërkoj në mënyrë paushalle pagesën e faturave, dhe se për një pjesë të faturave nuk ka arritur afati i maturimit sepse palët kanë marrëveshje për pagesë e cila nuk është arritur ende. I ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për përbarim.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke i kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pasafatshëm sepse është dorëzuar jashtë afateve të parapara ligjore, por në të njëjtën kohë duke theksuar se në prapësim debitori nuk ka bashkangjitur asnjë provë me të cilën dëshmohet se i njëjti ka kryer ndonjë pagesë për kreditorin, dhe fakti se debitori ka kryer pagesa të pjesshme nuk ia mohon të drejtën kreditorit që të kërkoj shumën e borxhit të papaguar. I ka propozuar gjykatës që të Prapësimi i debitorit të hedhet apo në alternativë të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata fillimisht trajtoj afatshmërinë e Prapësimi të debitorit, dhe nga shkresat e lëndës gjeti se debitori ka pranuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 242/21 të datës 07.10.2021 me datë 19.10.2021, fakt ky që vërtetohet nga fletë dërgesa për dorëzim personal e Përbaruesit Privat pjesë e shkresave të lëndës, ndërsa Prapësimin e ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 21.10.2021 fakt ky që vërtetohet nga zarfi i Postës së Kosovës me nr. rekomande R 1856537. Prapësimi në fjalë është vulosur me vulën e protokollit të Gjykatës me datë 22.10.2021 ndërsa është pajisur me vulën e Përbaruesit privat me datë 27.10.2021.

Në lidhje me këtë, me nenin 128 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcaktohet se *“Në qoftë se parashtrësja që lidhet me afat i është dorëzuar apo dërguar gjykatës jokompetente*

brenda afatit, kurse në gjykatën kompetente arrin pas skadimit te afatit, do të konsiderohet se është ruajtur afati po që se paraqitja e saj në gjykatën jokompetente mund t'i vishet padijenisë apo gabimit të hapur të parashtruesit". Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson që si datë e dorëzimit të Prapësimit duhet marrë data e dorëzimit të Prapësimit nga debitori në Postën e Kosovës me 21.10.2021, përkundër që Prapësimi gabimisht është drejtuar për në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe jo data e vulës së protokollit e Përmbauesit Privat, kjo pasi që dorëzimi i Prapësimit nga ana e debitorit direkt në Gjykatë dhe jo përmes Përmbauesit Privat i atribuohet gabimit të hapur të tij se mjeti juridik duhet të dorëzohet direkt në Gjykatën e cila e shqyrton atë, dhe jo përmes Përmbauesit Privat i cili ka lëshuar Urdhrin Përmbauesimor.

Mbi këtë bazë, meqenëse debitori ka pranuar Urdhrin Përmbauesimor P.nr. 242/21 të datës 07.10.2021 me datë 19.10.2021 ndërsa Prapësimin e ka dorëzuar me datë 21.10.2021, atëherë Gjykata vlerëson se Prapësimi është paraqitur brenda afatit të paraparë me nenin 70 të LPP-së i cili përcakton se *"Prapësimi duhet t'i paraqitet organit përmbaues brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbaues"*.

Gjykata tutje shqyrtoj themelësinë e Prapësimit, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ndërgjyqëse dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *"Përmbauesimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm"*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *"Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbauesim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar"*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *"Kur propozimi për përmbauesim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit."*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Faturat nr. 82/2021 të datës 30.03.2021, nr. 113/2021 të datës 19.04.2021, nr. 109/2021 të datës 16.04.2021, nr. 103/2021 të datës

13.04.2021, nr. 100/2021 të datës 08.04.2021, nr. 96/2021 të datës 06.04.2021, dhe faturës nr. 92/2021 të datës 03.04.2021 dhe faturës 85/2021 të datës 02.04.2021 në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes nënshkrimit.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se disa nga faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi nuk e kanë arritur afatin e maturimit, por gjeti se pretendimi në fjalë është i pabazuar sepse në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarrimit për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në propozimin për përmbarrim siç parashihet me dispozitën e nenit 40 par 1.2 të LPP-së, i cili përcakton se: *“1.Propozimi për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë:... kërkesën që organi përmbarrues ta detyrojë debitorin e përmbarrimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara...”*, ndërsa të njëjtat nuk janë përmbushur edhe pas pranimin të Urdhrit Përmbarrimor nga debitori.

Gjykata, vlerësoj edhe pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.997 /22, datë 28.04.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.